



Republika e Kosovës
Republik of Kosova
Republika Kosovo



Komuna e Vitisë
Municipality of Vitina
Opstina Vitina

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës neni 5 pika d, neni 35 pika 1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, dhe të Udhëzimit administrativ të MASHT-it Nr.08/14, të datës 25.02.2014, për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorëve dhe të zëvendës drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese, Drejtoria e Arsimit shpall:

KONKURSET PUBLIK (Rishpallje)

Për plotësimin e vendit të lirë të punës në institucionin edukativo- arsimor

- Drejtor në Çerdhen e fëmijëve „Gëzimi Ynë” në Viti

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët që konkurrojnë në këtë konkurs:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore,
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit,
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim, dhe
- Të kenë më së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

Të posedojnë këto dokumente:

- Çertifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës,
- Dëshminë për përvojën e punës;
- Portofolin profesionale (shih shtojcën G);
- Letër reference nga një institucion publik kredibil (Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, DKA, këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë);
- Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuuese për punën dhe angazhimet paraprake;
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave me 12, arial) sipas udhëzimit të MASHT-it;
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion shëndetësor publik me të cilën dëshmohet gjendja e tij / saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është nën hetime;
- Kopjen e letërnjoftimit.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegje private brenda Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji në pajtim me Udhëzimin Administrative Nr.8/2010, të datës 22.06.2010. Në të kundërtën, komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Kandidatët e interesuar aplikacionet i marrin dhe i dorëzojnë në Drejtorinë për Arsim të Komunës së Vitisë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Dokumentet e pa kompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Viti, më 11.05.2017

Drejtoria për Arsim e Komunës së Vitisë